



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr.195/ 2011**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ymer Hoxha, kryesues, Muhamet Rexha dhe Hasan Shala anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Numan Baliqit kryetar i subjektit politik Stranka Demokratska Akcije (SDA), paraqitur kundër Zyrës për Regjistrimin dhe Certifikimin e Partive Politike (ZRPPC)-(KQZ) , ne lidhje me refuzimin për bashkim e subjekteve politike SDA-së dhe BSDAK-së., në seancën e mbajtur më 23.03.2011, mori:

### VENDIM

**HIDHET** si e pasafatshme apeli i Numan Baliqit kryetar i subjektit politik Stranka Demokratska Akcije ( SDA).

### ARSYETIMI

Më datë 18.03.2011 PZAP-i ka pranuar një apel nga Numan Baliq kryetar i subjekti politik (SDA) paraqitur ndaj përgjigjes zyrtare të ZRPPC, lidhur me refuzimin për bashkimin e subjekteve politike SDA-së dhe BSDAK-së.

Parashtruesi i apelit thekson se Zyra për Regjistrim Partive Politike ka refuzuar të pranoj bashkimin e SDA-së dhe BSDAK-së në një parti unike SDA, pavarësisht faktit se i tërë procesi i bashkimit është bërë sipas procedurave të parapara dhe ne bazë të marrëveshjes paraprake me Drejtoreshën Ekzekutive Znj.Miradije Mavriqi.

Parashtrusi me tej thekson se në marrëveshjen e cila është e nënshkruar nga Znj.Miradije Mavriqi, është e qartë se është duke u shkelur rregulla ligjore e cila e rregullon këtë çështje dhe si arsyetim të vendimit është paraqitur një numër i madh i informatave(argumenteve) të pasakta:

Më tutje parashtruesi i apelit thekson se Zyra është e informuar me 10.03.2011, dhjetë ditë para mbajtjes së kuvendit dhe në bisedimet të drejtpërdrejta në mes te Baliqit dhe Ademit, përfaqësuesit të SDA-së dhe BSDAK-së dhe znj. Mavriqi. Në apel theksohet se nuk është e vërtetë se z Abaz Ademi është i përjashtuar nga BSDAK; dëshmi: lista zgjedhore e BSDAK-së në të cilën gjendet Ademi, i cili ka qenë bartësi i listës në zgjedhjet e fundit me propozim të Këshillit Kryesor të BSDAK-së.

Sipas parashtruesit te apelit, bashkimi i partive është bërë ne bazë të Rregullës Zgjedhore 01/2008 dhe nuk është e vërtetë se janë shkelur nenet 11.1 dhe 11.2. Sipas

tij, gjendja është krejtësisht ndryshe, sepse ata kanë vepruar mu në bazë të marrëveshjes me Znj.Mavriqi ku i kanë mbajtur mbledhjet e Këshillave Kryesore të SDA-së dhe BSDAK-së, dhe kopjet e tyre mbledhjeve janë dorëzuar Zyres për Regjistrim pranë KQZ-së, dhe në bazë të këtyre vendimeve e kanë mbajtur Kuvendin e gjithëpërfshirës të anëtareve të partisë, dhe procesverbalin, se bashku me 282 nënshkrimet e delegateve, dhe e kanë dorëzuar ZRPPC-së. Sipas parashtruesit të apelit, problemi kryesor i Znj. Mavriqi është se ajo ka marrë rolin e arbitrit dhe drejtpërdrejt është involvuar dhe përfshirë në punët brenda partisë BSDAK, duke e ka harruar pozitën e saj profesionale dhe neutrale, dhe duke u përpjekur që më forcë ta imponoj se kush do të jetë kryetari i BSDAK-së. Sipas pashtusit të apelit argumenti se Kandidi nuk e ka nënshkruar kërkesën e BSDAK-së, si kryetari i saj, nuk ka bazë, së pari sepse sipas Statutit të BSDAK-së ky vendim merret nga Këshilli Kryesor, dhe së dyti sepse Kuvendi i BSDAK-së është kryer në tërësi sipas procedurave, dhe po ashtu edhe kuvendi i gjithëpërfshirës i SDA-së ka konfirmuar vendimin e Këshillit Kryesor të BSDAK-së dhe është zgjedhur për kryetar të BSDAK-së Z.Abaz Ademi. Sipas parashtruesit të apelit, thelbi i apelit është pikërisht fakti që Znj.Mavriqi refuzon ta konfirmoj bashkimin e partive vetëm për shkak se Kandidi “kryetari i partisë” nuk është faktor kryesor në të gjithë këto ngjarje.

Parashtruesi më tutje në apel thekson se si dëshmi e manipulimeve të lartcekura të Kandidit, për shkak të cilëve është shkarkuar nga posti i kryetarit të partisë BSDAK, nga ana e Këshillit Kryesor dhe nga Kuvendi i BSDAK-së, është se Kandidi ka falsifikuar nënshkrimet e anëtareve të Këshillit Ekzekutiv (provat dhe deklaratat e të dëmtuarve janë dorëzuar në PZAP); pastaj për shkak se Kandidi nuk e ka lejuar asnjë herë të mbahet kuvendi i partisë BSDAK që nga viti 2000, dhe e ka lëshuar Kosovën dhe me familjen e tij jeton në Sarajevë, e në Kosovë vjen vetëm kur janë zgjedhjet dhe bën tregti me partinë e BSDAK-së, dhe në bazë të marrëveshjeve të ndryshme, bën tregti të ndryshme me partitë të ndryshme, më së pari me AKR-në e pastaj me LDD-në dhe tani me AAK-në; i realizon përfitimet personale duke i marrë të hollat pa njohuri të Këshillit Kryesor të partisë, si organ më të lartë të partisë BSDAK.

Prandaj parashtruesi i apelit kërkon që PZAP-i ta shqyrtojë apelin, dhe ta pranojë bashkimin dhe po ashtu të ndërmer masat për ta ndaluar veprimin e paligjshëm të Znj. Mavriqi, e cila poashtu vepron në bazë të interesave private.

PZAP- me datën 21.03.2011 në shkresën me numër 195/2 kërkoi informata shtesë nga ZRPPC-ja rreth asaj se kur i është dorëzuar përgjigja zyrtare mbi refuzimin për bashkim tek z.Numan Baliq, kryetar i SDA-së.

Me datën 22.03.2011 PZAP-i pranoi shkresën me numër 694 nga ZRPPC në të cilën theksohet se me 15 mars 2011 personi i autorizuar për kontakt me zyrë znj.Selma, është njoftuar me vendimin e cila më 16 Mars është njoftuar edhe me shkresë zyrtare. Po të njejtën ditë, kryetari i partisë politike SDA, z.Baliq e ka marrë përgjigjen e Zyres lidhur me kuvendin e përbashkët të BSDAK dhe SDA dhe është nënshkruar në librin e protokollit me datën 16.03.2011.

ZRPPC-ja si dëshmi ka bashkangjitur njoftimin e saj elektronik që i është bërë subjektit në fjalë dhe kopjen e faqes së librit të protokollit të nënshkruar nga z. Numan Baliqi me çka e ka pranuar përgjigjen nga ZRPPC-ja me datën 16.03.2011

**Rregulla Zgjedhore Nr.01/2008 : Neni 8.1 parasheh:**

*Partia politike mund të ushtrojë ankesë kundër vendimit të KQZ-së me të cilë refuzohet kërkesa për regjistrim, bashkim ose pezullim regjistrimi në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) brenda njëzet e katër (24) orëve pasi që vendimi i apeluar shpallet nga KQZ-ja dhe apeli duhet të vendoset nga PZAP-i brenda shtatëdhjet e dy (72) orëve pasi të jetë parashtruar apeli.*

PZAP gjeti se:

**-apeli është i pasafatshëm**

PZAP-i konstaton se apeli i paraqitur në PZAP nga Numan Baliqi kryetar i subjekti politik SDA, ndaj ZRPPC-se lidhur me refuzimin për bashkim të subjekteve politike BSDAK dhe SDA është i pasafatshëm, pasi që z. Numan Baliqit, përgjigja ju është dorëzuar nga ZRPPC-ja me datën 16.03.2011, ndërsa apeli në PZAP është bërë me datën 18.03.2011 gjë që është në kundërshtim me nenin 8.1 të Rregullës Zgjedhore Nr. 01/2008, me ç'rast ka kaluar afati i paraparë ligjor prej njëzet e katër (24) orëve për apelim në PZAP.

Prandaj për këto arsye si dhe ne kuptim të nenit 115.1 të LPZ-se, PZAP mori vendim si ne dispozitiv të këtij vendimi

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LPZ-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 195/2011 më datën 23.03.2011.

**Kryesuesi i Panelit**

**Ymer Hoxha**

